

Emertimi dhe forma ligjore	GEGA OIL GROUP SHA
NUIS-i	K76911001E
Adresa e Selise	Rr. Ali Demi, prane Karburant Gega Oil, Kati II-te TIRANE
Data e krijimit	28.05.2007
Nr.i Regjistrimit Tregtar	33592
Veprimtaria Kryesore	Tregti me shumice e karburanteve

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit nr 2 dhe ligjit
Nr 9228, Date 29,04,2004 " Per Kontabilitetin dh Pasqyrat Financiare")

VITI 2022

Pasqyrat Financiare jane individuale	_____ PO _____
Pasqyrat Financiare jane te konsoliduara	_____ JO _____
Pasqyrat Financiare jane te shprehura ne	_____ leke _____
Pasqyrat Financiare jane te rrumbullakosura ne	_____ 1 LEK _____
Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare	Nga 01,01,2022 Deri 31,12,2022
Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare	25.03.2022



PERMBAJTJA:

PASQYRAT FINANCIARE

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

**PASQYRA E PERFORMANCES DHE TE ARDHURAVE TE TJERA
GJITHEPERFSHIRESE**

SHENIME SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE



Gega Oil Group SHA

Pasqyra e Pozicionit Financiar per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(shumat ne LEK)

AKTIVET	Shenime	Me	Me
		31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Aktive Afatshkurtra			
Mjete monetare		124,624,150	153,426,130
Banka		124,624,150	153,426,130
Arka		0	0
Investime		0	0
Te drejta te arketueshme		5,408,718,433	4,415,423,171
Nga aktiviteti i shfrytezimit		2,325,685,833	2,410,406,845
Te tjera		204,656,251	146,293,944
Te arketueshme tatimore		0	0
Te drejta dhe detyrime ndaj pjesetareve te tjere te grupit		0	0
Inventaret		2,878,376,349	1,858,722,328
Mallra		2,872,270,156	1,858,722,382
Parapagime per inventar		6,106,193	0
Totali i Aktiveve Afatshkurtra		5,533,342,583	4,568,849,301
Aktivet Afatgjata			
Aktive financiare		0	0
Tituj te huadhenies		0	0
Aktivet materiale		1,153,498,126	1,123,877,790
Toka dhe ndertesa		979,207,837	1,014,149,407
Impiante dhe makineri		81,127,524	91,882,057
Te tjera aktive materiale		96,585	138,630
AA Materiale ne process		93,066,180	17,707,696
Aktive tatimore te shtyra		-	-
Kapitali i nenshkruar i papaguar		-	-
Totali i Aktiveve Afatgjata		1,153,498,126	1,123,877,790
Totali i Aktiveve		6,686,840,709	5,692,727,091

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese, te cilat jane pjese perberese e Pasqyrave Financiare.



Gega Oil Group SHA

Pasqyra e Pozicionit Financiar per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022

(shumat ne LEK)

DETYRIMET DHE KAPITALI	Shenime	Me 31 dhjetor 2022	Me 31 dhjetor 2021
Detyrime Afatshkurtra			
<i>Detyrime ndaj institucioneve te kredise</i>		1,216,979,997	1,222,638,413
<i>Arketime ne avance per porosi</i>		76,040,488	1,441,940
<i>Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit</i>		2,577,234,401	1,556,820,150
<i>Te pagueshme ndaj punonjesve</i>		0	181,910
<i>Te pagueshme per detyrime tatimore</i>		1,700,280	5,640,073
<i>Te tjera te pagueshme</i>		1,052,487,223	1,118,543,680
Provizione		-	-
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra		4,924,442,389	3,905,266,166
Detyrime Afatgjata		-	-
<i>Detyrime ndaj institucioneve te kredise</i>		225,628,490	388,999,409
<i>Te ardhura te shtyra</i>		-	-
Provizione		-	-
<i>Detyrime tatimore te shtyra</i>		-	-
Totali i Detyrimeve Afatgjata		225,628,490	388,999,402
Totali i Detyrimeve		5,150,070,879	4,294,265,568
Kapitali dhe Rezervat			
Kapitali i nenshkruar		1,045,000,000	893,000,000
Fitimi i akumuluar			
Rezervat te tjera		343,461,523	332,694,488
<i>Rezerva ligjore</i>		85,311,263	74,544,228
<i>Rezerva te tjera</i>		258,150,260	258,150,260
Fitimi (humbja) e pa shperndare		0	20,253,976
Fitimi (humbja) e periudhes		148,308,307	152,513,059
Totali i kapitalit		1,536,769,830	1,398,461,523
Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit		6,686,840,709	5,692,727,091

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese, te cilat jane pjese perberese e Pasqyrave Financiare.



Gega Oil Group SHA

Pasqyra e te ardhurave te tjera gjithëpërshiresë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016

(Shumat në LEK)

Sheni me	Per periudhen e mbyllur me 31 dhjetor 2022	Per periudhen e mbyllur me 31 dhjetor 2021
Te ardhura nga aktiviteti kryesor	44,209,269,676	36,080,291,933
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimin në proces	-	-
Puna e kryer nga njesia ekonomike dhe e kapitalizuar	-	-
Te ardhura të tjera nga aktiviteti i shfrytëzimit	75,709,153	4,266,495
Lende e pare dhe materiale të konsumueshme	(43,866,190,978)	(35,727,745,727)
Lende e pare dhe materiale të konsumueshme	(43,296,343,573)	(35,682,985,406)
Te tjera shpenzime	(569,847,405)	(44,760,321)
Shpenzime të personelit	(64,452,547)	(60,059,556)
Paga dhe shpërblime	(55,363,625)	(51,479,540)
Shpenzime sigurimesh shoqërore dhe shëndetësore	(9,088,922)	(8,580,016)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	-	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	(46,728,148)	(49,604,029)
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	-	-
Shpenzime të tjera	-	-
Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra	-	-
Te ardhura/(shpenzime) të tjera financiare	(133,106,263)	(67,330,427)
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	(64,243,426)	(68,751,952)
Shpenzime të tjera financiare (diferenca kembimi)	(68,862,837)	1,421,425
Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet	-	-
Fitimi para tatimit	174,500,893	179,818,589
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	(26,192,586)	(27,305,530)
Fitimi neto i vitit 2022	148,308,307	152,513,059

Pasqyra e Performances dhe te ardhurave te tjera gjithëpërshiresë duhet lexuar së bashku me shenimet shpjeguese, të cilat janë pjesë përbërëse e Pasqyrave Financiare.



SHENIME SHPJEGUESE PER PASQYRAT FINANCIARE VITI USHTRIMOR 2022

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

Shoqeria "Genklaudis" SHA eshte themeluar si Shoqeri Anonime me date 28.05.2007 dhe eshte rregjistruar ne Gjykatën e rrethit Gjyqesor Tirane me Vendimin 33592 date 28.05.2007.

Kapitali sipas aktit te themelimit ka patur vleren 2.500.000 leke.

Shoqeria eshte e rregjistruar ne organin tatimor me NIPT K76911001E dhe administrimi tatimor kryhet nga Drejtoria e Tatimpaguesve te Medhenj, Tirane.

Objekti kryesor i veprimtarise se Shoqerise eshte import-export tregeti me shumice i karburanteve si me poshte:

Tregtimi me shumice i naftes, gazit, nenprodukteve, perfshire ato bio, si dhe lendeve djegese, duke perfshire gjithashtu si me poshte vijon: tregtimi me shumice i naftes bruto e nenprodukteve te saj te kategorive 0, II, III, IV e V, pa perjashtuar te nenprodukteve qe destinohen per furnizimin e mjeteve te fluturimit ajror; tregtimi me shumice i gazit te lengshem te naftes, kategoria I, perfshire edhe mbushjen e bombolave me kete nenprodukt; tregtimi me shumice i karburanteve, kategorite II/B e III/C, per mjetet e fluturimit. Import eksport tregtimi me shumice e pakice te karburanteve, lubrifikanteve, vajrave, graso, gaz e lende djegese te te gjitha 2 llojeve dhe kategorive.

Ne vitin 2021 eshte bere bashkimi me perthithje (ka perthithur) me shoqerine Gega Oil SHA me NUIS L61322038Q ku kjo e fundit eshte shoqeria e perthithur nga Gennklaudis SHA.

Mbas bashkimit me perthithje kapitali i shoqerise ka shkuar ne shumen 393,000,000 leke.

Gjithashtu ne vitin 2021 shoqeria ka nderruar emrin nga Genklaudis SHA ne Gega Oil Group SHA.

Gjate vitit 2021 shoqeria Gega Oil Group SHA ka rritur aktivitetin e vet ne tregtimin me shumice te produkt diesel dhe benzine .

Shitjet jane realizuar ne tregun vendas ne 55 % te sasise totale dhe me pak se 45 % jane kryer eksporte.

Sasia totale e shitur per produktin diesel eshte 383,147,387 litra dhe per produktin benzine 40,068,723 litra.

Ne baze te Vendimit te Aksionereve te marre me 30.11. 2022 "Shqyrtimi i raportit te zmadhimit te kapitalit", Asambleja ka miratuar alokimin e fitimit te shoqerise Gega Oil SHA ne shumen 20,253,975 leke (qe u perthith nga Gega Oil Group SHA) dhe fitimit neto pas bashkimit ne shumen 152,513,059 leke te vitit ushtrimor 2021, ne rritje kapitali ne vleren 152,000,000 leke dhe ne rritje te rezervave ligjore ne vleren 10,767,034 Leke.

Ne baze te vendimit te marre, Shoqeria ka paraqitur ne Pasqyren e Ndryshimeve ne Kapitalin Neto alokimin e fitimit neto nje pozicion financiar te deklaruar me 31 Dhjetor 2022 si "Kapital"dhe "Rezerva Ligjore" per shumat respektive.

Kapitali pas rritjes shkon ne vleren 1,045,000,000 leke.

Aksioneret e shoqerise jane:

Z.Paulin Gega 82% te kapitalit, ose 956,900 aksione me vlere 1,000 leke/secili.

Z.Genc Gega 9% te kapitalit, ose 94,050 aksione me vlere 1,000 leke/secili.

Z.Klaudio Gega 9% te kapitalit, ose 94,050 aksione me vlere 1,000 leke/secili.



Gjate vitit 2022 shoqeria Gega Oil Group SHA ka ulur aktivitetin e vet ne tregtimin me shumice te produkt diesel dhe benzine, per shkak edhe te rritjeve te cmimeve te karburanteve ne burse dhe te kerkesave me te pakta te klienteve, per shkak te kesaj krize ne rritje.

Shitjet per vitin 2022 gjithsej jane: Diesel ne sasine 296,526,940 litra dhe Benzine ne sasine 28,051,007 litra dhe jane realizuar si me poshte:

Ne tregun vendas

Shitje ne zone te lire

Diesel 8.49%

Benzine 4.1%

Shitje subjekteve per rindertim

Diesel 0.44%

Shitje ne tregun vendas me TVSH

Diesel 43.57%

Benzine 87.29%

Per shitje Export

Diesel 47.5%

Benzine 8.61%

Sasia totale e karburanteve tregetuar per vitin 2022 eshte 324,577,946 litra.

Ne rraport me sasite e shituar total ne vitin 2021, per vitin 2022 jane shitur gjithsej karburante ne sasine 98,638,164 litra me pak se viti 2021.

Shitjet kryhen ne tre adresa te ndryshme si me poshte:

-Porto Romano Durres, Magazine e Lire.

-Bletoje, Shkoder.

-Vrrine, Durres.

Gjate vitit 2022, Shoqeria ka deklaruar mesatarisht 49 punemarres, per nje muaj.

Personi pergjegjes per hartimin e pasqyrave financiare eshte **Z.Fatos Muçaj** me Nr personal ID G80405090W i punesuar prane kompanise Gega Oil Group SHA si specialis finance qe nga data 01 Mars 2021 dhe prej dates 01.01.2023 si Drejtor i Departamentit te Finances.

2. BAZAT E PERGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE

2.1 Deklarata e pajtueshmerise

Pasqyrat financiare jane pergatitur dhe paraqitur ne perputhje me Standardin Kombetar te Kontabilitetit nr. 2 te permiresuar (SKK 2) dhe ne baze te Ligjit 25/2018, date 10.05.2018, "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes



Keto pasqyra financiare individuale jane pergatitur dhe paraqitur ne Lek, e cila eshte edhe monedha funksionale e Shoqerise.

2. BAZAT E PERGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

2.4 Vleresime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kerkon qe Drejtimi i Shoqerise te kryeje vleresime dhe supozime qe ndikojne shumat e raportuara te aktiveve, detyrimeve te kushtezuara ne daten e pasqyres se pozicionit financiar, si dhe te ardhurave dhe shpenzimeve te krijuara ne periudhen kontabel. Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon nga drejtuesit te ushtrojne gjykimin e tyre ne procesin e zbatimit te politikave kontabel te Shoqerise dhe shumave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve.

Rezultati aktual mund te ndryshoje nga keto vleresime. Vleresimet dhe gjykimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme dhe bazohen ne eksperiencen e meparshme dhe faktore te tjere duke perfshire pritshmerine per ngjarjet e ardhshme te cilat besohen te jene te arsyeshme ne rrethanat aktuale. Drejtimi kryen vleresime dhe gjykime ne lidhje me te ardhmen. Vleresimet kontabel qe rezultojne sipas perkufizimit, jo gjithmone do te barazohen me rezultatet aktuale. Vleresimet dhe supozimet qe kane risk te rendesishem per te shkaktuar korrigjime materiale, te vlerave te mbartura te aktiveve dhe detyrimeve jane pershkruar me poshte.

2.5 Zhvleresimi i te drejtave te arketueshme

Zhvleresimi i te drejtave te arketueshme bazohet ne humbjet e vleresuara te cilat rezultojne nga pamundesia per te paguar detyrimet. Keto vleresime bazohen ne moshen e te drejtave te arketueshme dhe eksperiencen e meparshme ne ç'regjistrimin, vleresimin e aftesise paguese te klienteve, si dhe ndryshimet e fundit dhe te pritshme te termave te pageses. Drejtimi vlereson ne fund te cdo periudhe ne rast se ka nevojte per zhvleresim te tyre.

2.6 Provizionet

Provizionet ne pergjithesi kerkojne nje nivel te larte gjykimi, vecanerisht ne rastet e çeshtjeve gjyqesore. Shoqeria vlereson mundesine e krijimit te detyrimit aktual si rrjedhoje e nje ngjarje te shkuar, ne rast se mundesia e ndodhjes vleresohet te jete me shume se 50%. Ne te tilla raste Shoqeria provizionon vleren e detyrimit e cila mund te matet me besueshmeri. Per shkak te nivelit te larte te pasigurise, ne disa raste mund te ndodhe qe vleresimi mund te mos jete ne te njejten linje me rezultatit e ceshtjes. Drejtimi vlereson ne fund te çdo periudhe ne rast se ka nevojte per krijimin e provizioneve.

3. POLITIKAT KONTABEL

Politikat kontabel te meposhtme jane aplikuar ne menyre konsistente ne te gjitha periudhat e paraqitura ne pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e bilancit. Fitimi ose humbja nga kembimi ne zera monetare eshte diferenca qe vjen nga kembimi i nje numri te caktuar njesish te nje monedhe te huaj ne monedhen funksionale me kurse te ndryshme kembimi ne datat e kembimit.



3. POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)

3.1 Transaksionet ne monedhe te huaj (vazhdimi)

Te drejtat dhe detyrimet jo-monetare ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit ndersa ato qe maten me vlere te drejte rikembehene ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates kur eshte percaktuar vlere e drejte. Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i kembimit i monedhave te huaja me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 eshte detajuar si me poshte:

Kursi i kembimit	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Euro/Lek	114.23	120.76
USD/Lek	107.05	106.54

3.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiare perbehen nga mjetet monetare, instrumenta borxhi (si llogari, deftesa ose hua te arketueshme ose te pagueshme) dhe nga zotime per te marre hua, te cilat plotesojne kushtet e instrumentave te borxhit.

Nje instrument financiar njihet nese Shoqeria behet pjese e kushteve kontraktuale te instrumentit. Instrumentat financiare njihen fillimisht me koston e transaksionit (duke perfshire edhe cmimin e transaksionit). Kostoja eshte (a) vlere e drejte e parase ose e ekuivalenteve te saj te paguara ose vlere e drejte e shperblimeve te dhena per te blere nje aktiv ne kohen e blerjes ose te ndertimit te tij; (b) shuma e parase ose e ekuivalenteve te saj te arketuara ose vlere e drejte e shperblimeve te marra per te shitur nje detyrim ne kohen e shitjes ose likuidimit te tij.

Aktivitetet financiare cregjistrohen kur skadojne/shlyhen te drejtat kontraktuale te Shoqerise ndaj flukseve te parase nga aktiviteti financiar ose kur Shoqeria transferon aktivitetin financiar tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithesisht risqet dhe perfitimet thelbesore te aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qe eshte data ne te cilen njesia ekonomike angazhohet te bleje apo te shese aktivitetin. Detyrimet financiare cregjistrohen nese detyrimet kontraktuale te Shoqerise shlyhen, anulohen ose skadojne.

Aktivitetet monetare

Aktivitetet monetare perfshijne arken, llogaritete rrjedhese dhe depozitat ne banke. Per qellimin e pasqyres se fluksit te parase, aktivitetet monetare perfshijne depozita me afat me nje maturim prej tre muajsh ose me pak qe nga data e fillimit.

Te drejtat e arketueshme

Te drejtat e arketueshme njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvleresimi. Provizionet per zhvleresimin e aktiveve te arketueshme llogaritet kur ka te dhena se Shoqeria nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Veshitesite financiare te debitorit, mundesia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues qe te drejtat e arketueshme te zhvleresohen. Shuma e provizionit llogaritet si difference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen e interesit efektiv.



3. POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)

3.2 Instrumenta financiare (vazhdim)

Llogari te pagueshme

Llogarite e pagueshme paraqiten me kosto dhe me pas me kosto te amortizuar, duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Tituj te huadhenies dhe huamarrjes

Tituj te huadhenies dhe huamarrjes njihen me kosto minus zhvleresim, pa perfshire koston e transakcioneve. Humbja nga zhvleresimi eshte diferenca mes vleres kontabel te aktivitetit dhe vleresimit me te mire qe njesia mund te marre per aktivitetin nese ai do te shitej ne daten e raportimit. Interesat e njohura ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve jane perllogaritur mbi bazen e interesit nominal.

3.3 Inventaret

Shoqeria ka mbajtur rregullisht inventare edhe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022. Inventaret njihet fillimisht me kosto historike dhe ne vijim vleresohet me vleren me te ulet mes koston dhe cmimit te vleresuar te shitjes i pakesuar me koston per tu perfunduar. Kostoja e inventarit perfshin koston e te gjitha mallrave dhe materialeve te lidhura drejtperdrejt me prodhimin dhe koston e shnderrimit te ketyre materialeve ne produkte perfundimtare. Kur inventaret konsumohen, vlera e tyre e mbetur njihet si shpenzim ne periudhen ne te cilen e ardhura perkatese njihet. Shuma e renies ne vleren e inventareve deri ne cmimin e realizuar te shitjes si dhe te gjitha humbjet nga inventaret njihen si shpenzime ne periudhen ne te cilen renia ne vleren apo humbja ndodh.

3.4 Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Zerat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shih me poshte) dhe humbjet e akumuluar nga zhvleresimi.

Kur pjese te nje elementi te aktiveve afatgjata materiale kane jetegjatesi te dobishme te ndryshme, ato kontabilizohen si elemente te vecanta te aktiveve afatgjata.

Kostot vijuese

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje elementi te aktiveve afatgjata materiale njihet me vleren e mbartur te elementit nese eshte e mundshme qe perfitimet ekonomike te ardhshme qe i atribuohen atij elementi t'i perkasin Shoqerise, dhe nese kostoja e tij mund te matet me besueshmeri. Kostot e sherbimeve ditore te aktiveve afatgjata materiale njihen ne fitim ose humbje ne momentin kur ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi njihet ne fitim ose humbje gjate jetes se dobishme te aktiveve. Metodatat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur (nese eshte e konsiderueshme) rivleresohen ne daten e raportimit. Per periudhen e mbyllur me 31 Dhjetor 2022, Shoqeria ka mbajtur aktive afatgjata te grupuara ne kategorite dhe te amortizuara per periudhen e raportimit me metodatat dhe normat amortizimit si me poshte.



3. POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)

3.4 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Amortizimi (vazhdim)

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke perdorur metoden e vleres se mbetur te amortizimit mbi jeten e vleresuar te cdo pjese te aktivitetit afatgjate material duke filluar nga dita e pare e muajit qe pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira shoqeria jone nuk ka, por po te kishte ato do te amortizoheshin duke marre per baze periudhen me te shkurter midis periudhes se qirase dhe jetes se dobishme te aktivitetit.

Jetegjatesia e vleresuar per vitin aktual eshte si me poshte:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndertime	Vlere e mbetur	5%
Makineri e paisje	Vlere e mbetur	5%
Mjete transporti	Vlere e mbetur	20%
Paisje zyre	Vlere e mbetur	20%
Paisje kompjuterike	Vlere e mbetur	25%

Nje ze i aktiveve afatgjata materiale ç' regjistrohet kur ai shitet ose nxirret jashte perdorimit apo atehere kur nuk priten me perfitime ekonomike te ardhshme nga perdorimi.

3.5 Provizionet

Nje provizion njihet kur, si rezultat i nje ngjarjeje te shkuar, Shoqeria ka nje detyrim aktual (ligjor apo konstruktiv), i cili ka shume gjasa te ndodhe (mbi 50%), matet me besueshmeri dhe ne te ardhme do te krijoj flukse dalese parash prej shlyerjes se tij. Provizionet percaktohen duke skontuar flukset e pritshme te ardhshme te parase me nje norme skontimi para tatimit qe pasqyron vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe per risqet qe lidhen me detyrimet ne fjale. Provizionet rishikohen ne cdo date raportimi dhe nese nuk ka me gjasa per daljen e ndonje fluksi parash per shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren. Shoqeria nuk ka njohur asnje provizion per periudhen e mbyllur me 31 dhjetor 2022, pasi nuk ka patur asnje ngjarje te shkaktuar qe te tregojte per nje detyrim aktual me probabilitet me te larte se 50% per te ndodhur.

3.6 Aktivitetet dhe detyrimet e kushtezuara

Aktivitetet e kushtezuara nuk paraqiten ne pasqyrat financiare, por paraqiten ne shenime per sa kohe ekziston mundesia e hyrjes se perfitimeve ekonomike. Detyrimet e kushtezuara nuk njihen ne pasqyrat financiare. Ato paraqiten ne shenime te pasqyrave financiare per aq kohe qe mundesia per nje dalje te burimeve qe perfshijne perfitime ekonomike eshte e larget. Shuma e humbjeve te kushtezuara njihet si provizion, nese eshte e mundshme qe ngjarjet e ardhshme te konfirmojne qe nje detyrim ka lindur ne daten e pozicionit financiar dhe mund te behet nje vleresim i arsyeshem dhe i besueshem i shumes.

3.7 Te ardhurat

Te ardhurat njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur produktet dhe sherbimet jane perfunduar, kryer, ne perputhje me SKK 8 "Te ardhurat".

Ne rastet kur rezultati i nje transaksioni qe perfshin ofrimin e sherbimeve mund te matet me besueshmeri, te ardhurat e lidhura me kete transaksion njihen ne varesi te fazes se perfundimit te sherbimit.



periudhes se raportimit. Rezultati i nje transaksioni mund te matet me besueshmeri kur plotesohen te gjitha kushtet e meposhtme:

3. POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)

3.7 Te ardhurat (vazhdim)

- i. Shuma e te ardhurave mund te matet me besueshmeri;
- ii. Arketimi i pageses nga kryerja e sherbimit eshte i mundur;
- iii. Volumi i kryerjes se shitjeve dhe sherbimit ne daten e bilancit mund te matet me besueshmeri;
- iv. Shpenzimet e bera per shitjet dhe sherbimin, si dhe ato qe do te behen per perfundimin e tij mund te maten me besueshmeri.

Te ardhurat gjenerohen nga shitjet e kryera klienteve, brenda vendit dhe jashte vendit dhe sherbimet e ofruara klienteve bazuar edhe ne kontratat dhe njihen sipas cmimeve per njesi per çdo kontrate te realizuar.

Te ardhurat nga shitja e mallrave dhe sherbimeve do te njihen vetem nese plotesohen te gjitha kushtet e meposhtme:

- Shoqeria ka transferuar tek bleresi riskun dhe te drejten e pronesise lidhur me mallin/sherbimin e shitur;
- Shoqeria nuk ushtron perfshirje te vazhdueshme manaxheriale, zakonisht te lidhur me pronesine apo kontrollin mbi mallrat/sherbimet e shitura;
- Shuma e te ardhures se perfutur mund te matet ne menyre te besueshme;
- Eshte e mundur qe perfitimet ekonomike te lidhura me kryerjen e veprimit te shitjes se mallrave te hyjne ne nje njesine ekonomike;
- Kostot e lidhura me shitjen e mallit/sherbimit mund te maten ne menyre te besueshme.

3.8 Te ardhurat e tjera te shfrytezimit

Te ardhurat te tjera te shfrytezimit perfitoen jashte rrjedhes normale te veprimtarise ekonomike, duke perfshire fitimet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale ndryshimet ne llogarite/kerkesat e arketueshme dhe detyrimet per t'u paguar furnitoreve (nese rezulton nje humbje neto, ajo njihet ne zerin "Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit").

3.9 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhura interesi nga llogarite bankare dhe fitime nga kursi i kembimit qe njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Te ardhurat nga interesi njihen mbi bazen e te drejtave te konstatuara duke perdorur metoden e interesit efektiv. Shpenzimet financiare perfshijne shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i kembimit, ndryshimet ne vleren e drejte te aktiveve financiare te mbajtura me vlere te drejte nepermjet llogarise fitim/humbje dhe humbjet nga zhvleresimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve me metoden e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet nga kurset e kembimit raportohen ne baze neto.

3.10 Shpenzimet e personelit

Kontributet e detyrueshme per sigurimet shoqerore

Njesia ekonomike paguan vetem kontributet per sigurimet shoqerore te detyrueshme qe percaktojne perfitimet e punonjesve qe dalin ne pension. Autoritetet tatimore jane pergjegjese per percaktimin e limitit ligjor te vendosur per pensionet ne Shqiperi sipas nje plani kontributesh pensioni te percaktuar. Kontributet e Shoqerise ndaj planit te pensioneve ngarkohen ne fitim ose humbje kur ato ndodhin.



3. POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)

3.10 Shpenzimet e personelit (vazhdim)

Shoqeria ka deklaruar, perllogaritur dhe paguar kontribute te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore ne skemen e detyrueshme te kontributeve ne perputhje me Ligjin nr. 9136, date 11.09.2003 "Per mbledhjen e detyrueshme te kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore" si dhe Udhezimit perkates nr. 26, date 16 prill 2009, per 49 punonjes mesatarisht ne muaj per gjate gjithe vitit 2022.

3.11 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin perfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtperdrejte ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i vitit eshte tatimi i pritshem per t'u paguar mbi te ardhurat e tatueshme te vitit, duke perdorur normat tatimore te miratuara gjate vitit.

Tatimi mbi fitimin llogaritet duke u bazuar ne ligjin 8438, date 29 dhjetor 1998, "Per tatimin mbi te ardhurat", i ndryshuar. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin perfshin te gjithe barren per vitin korrent.

Aktiviteti qe kryen Shoqeria eshte plotesisht ne perputhje me percaktimet e ligjeve specifike per tregetimin e hidrokarbureve dhe ligjeve tatimore ne fuqi.

4. Aktive monetare

Aktive monetare me 31 dhjetor 2022 perbehen nga sa me poshte:

	Me 31 dhjetor 2022
Aktive monetare	
Arka:	
Arka ne monedhe Euro	0
Arka ne monedhe vendase	0
Totali	0
Banka:	
Llogari bankare ne monedhe vendase	20,556,124
Llogari bankare ne monedhe Euro	11,693,456
Llogari bankare ne monedhe USD	92,374,570
Totali	124,624,150

5. Te drejta te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit

Te drejta te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit me 31 dhjetor 2022 jane ne shumen **2,325,685,833 leke** dhe jane klient per te cilet eshte kryer furnizim me mall, eshte leshuar fature tatimore e fiskalizuar por ne fund te vitit 2022 jane pa arketuar akoma.

Per kete shoqeria disponon listen perkatese te klienteve dhe shumat perkatese te detyrimit.



6. Te drejta te tjera te arketueshme

Te drejta te tjera te arketueshme me 31 dhjetor 2022 jane ne shumen **204,656,251 leke** dhe jane si me poshte:

Tatim mbi fitimin	1,617,415 leke
TVSH e zbriteshme	111,117,640 leke
Te tjera tatime per tu paguar dhe per tu kthyer	49,351,765 leke
Tatim taksa ne Dogane	41,461,083 leke
Manushi SHPK	1,056,348 leke
RBH Belinë SHA	52,000 leke.

7. Inventaret mallrat

Mallrat gjendje me 31 dhjetor 2022 jane ne shumen **2,872,270,156 leke** perbehen nga sa me poshte:

Emertimi	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera ne leke	Vend ndodhja MG-se
Gazoil D1	litra	88,861.60	153.365	13,628,259.28	Beltoje, Shkoder
Benzine	litra	23,821.13	139.682	3,327,390.76	Beltoje, Shkoder
Gazoil D1	litra	24,603,919.90	79.150	1,947,400,260.09	Porto Romano, Durres
Benzine	litra	12,586,441.00	68.790	865,821,276.39	Porto Romano, Durres
Gazoil D1	litra	240,059.00	151.890	36,462,561.51	Vrrine, Durres
Benzine	litra	40,600.00	138.680	5,630,408.00	Vrrine, Durres
Gazoil D1	litra	24,932,840.50		1,997,491,080.88	Shuma
Benzine	litra	12,650,862.13		874,779,075.15	Shuma
				2,872,270,156.02	Totali

8. Parapagimet per inventar

Parapagimet per inventar jane faturat e fiskalizuar te leshuara nga furnitoret tane te cilet kerkojne te parapaguajme shumen monetare perpara se te na levrohet malli apo artikuj te tjere shume e cila eshte **6,106,193 leke** dhe perbehet nga si me poshte:

GFI Albania SHPK	2,213,857.61 leke
Lavdrim Shoku PF	3,892,334.94 leke
Shuma	6,106,192.55 leke

9. Aktive afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale me 31 dhjetor 2022 perbehen nga sa me poshte:



Aktivitet Afatgjata Materiale me vlere fillestare 2022

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2022	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2022
1	Toka		315,318,000			315,318,000
2	Truall dhe ndertese		0			0
3	Ndertime		911,750,265			911,750,265
4	Makineri, paisje		122,396,286			122,396,286
5	Mjete transporti		55,732,042	990,000		56,722,042
6	Paisje Zyre		775,645			775,645
7	Paisje kompjuterike		1,693,734			1,693,734
8	AA Materiale ne proces		17,707,696	75,358,484		93,066,179
9			0			0
10			0			0
	TOTALI		1,425,373,668	76,348,484	0	1,501,722,151

Amortizimi A.A.Materiale 2022

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2022	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2022
1	Toka		0			0
2	Truall dhe ndertese		0			0
3	Ndertime		212,918,858	34,941,570		247,860,428
4	Makineri, paisje		78,154,333	2,212,827		80,367,160
5	Mjete transporti		8,091,938	9,531,706		17,623,644
6	Paisje zyre		746,369	12,761		759,130
7	Paisje kompjuterike		1,584,380	29,284		1,613,664
8	AA Materiale ne proces		0			0
9			0			0
10			0			0
	TOTALI		301,495,878	46,728,148	0	348,224,026

Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 2022

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2022	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2022
1	Toka		315,318,000	0	0	315,318,000
2	Truall dhe ndertese		0	0	0	0
3	Ndertime		698,831,407	-34,941,570	0	663,889,837
4	Makineri, paisje		44,241,953	-2,212,827	0	42,029,127
5	Mjete transporti		47,640,104	-8,541,706	0	39,098,398
6	Paisje zyre		29,276	-12,761	0	16,515
7	Paisje kompjuterike		109,354	-29,284	0	80,070
8	AA Materiale ne proces		17,707,696	75,358,484	0	93,066,179
9			0	0	0	0
10			0	0	0	0
	TOTALI		1,123,877,790	29,620,335	0	1,153,498,125



10. Detyrime afatshkurtra ndaj institucioneve te kredise

Detyrimet afatshkurtra ndaj institucioneve te kredise me 31 dhjetor 2022 jane ne shumen **1,216,979,997 leke** dhe jane overdrafte te marra ne banka te nivelit te dyte si me poshte:

OTP Banke ALL ne shumen 804,406,991.47 leke.

Raiffeisen Bank ALL ne shumen 412,573,006.22 leke.

11. Arketime ne avance per porosi

Kjo shume me 31.12.2022 eshte **76,040,488.23 leke** perfaqeson shumen per te cilen shoqeria jone per klientet te cilet duan te parapaguajne blerjen e mallit dhe akoma nuk e kane marre mallin, shume e cila me 31.12.2022 perbehet nga:

AEOT SHA	21,545,669.51 leke
Daku SHPK	8,292,902.69 leke
ERAA-06 SHPK	41,791.76 leke
GPG Company SHPK	41,666,666.67 leke
Krasniqi SA SHPK	2,413,457.60 leke
SMO Union SHPK	2,080,000.00 leke
Shuma	76,040,488.23 leke

12. Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit

Llogari te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit me 31 dhjetor 2022 ne shumen **2,577,234,401 leke** perfaqeson shumen qe shoqeria jone ka ndaj furnitoreve te saj. Ne kete shume rreth 90% eshte shuma e pa likujduar per furnitorin kryesor te karburanteve me qender ne Londer OMV.

Shoqeria disponon listen e furnitoreve dhe me shumet perkates te detyrimit ndaj tyre.

13. Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurmeve shoqerore dhe shendetesore

Te pagueshme ndaj punonjesve me 31 dhjetor 2022 eshte ne shumen **zero leke**, kjo per arsye se shoqeria jone pagat e muajit dhjetor 2022 i kaloi ne llogarine e punonjesve ditet e fundit te dhjetor 2022.

14. Te pagueshme per detyrimet tatimore

Te pagueshme per detyrime tatimore me 31 dhjetor 2022 ne shumen **1,700,280 leke** perbehen nga sa me poshte:

Sigurimet shoqerore dhe shendetesore ne shumen 1,278,078 leke.

Tatimi mbi te ardhurat personale ne shumen 422,202 leke.

15. Te tjera te pagueshme

Te tjera te pagueshme me 31 dhjetor 2022 ne shumen **1,052,487,223 leke** jane kryesisht te pagueshme ndaj shoqerive te kembimit valutor dhe ndaj shoqerive per te cilat eshte marre hua dhe perbehen nga sa me poshte:



Te drejta dhe detyrime ndaj ortakeve dhe aksionereve	38,525,931
SHFT-08 SHPK	403,908,783
Ballkan Energji SHA	61,108,357
Adon SHPK	23,180,479
Buxha SHPK	508,500
Gezim Aliaj	24,784,000
Vil Oil SHA (Auto Gril Vilsoni)	42,948,699
Brandon Krasniqi	22,829,812
Izvor 99 SHA	501,900
Rebani Likometa	11,734,100
Jera Construction SHPK	228,460,000
Alb For Ex SHPK	193,996,662

16. Detyrime afatgjata ndaj institucioneve te kredise

Detyrimet afatgjata ndaj institucioneve te kredise me 31 dhjetor 2022 jane ne shumen **225,628,490 leke** dhe jane kredi afatgjata te marra ne banken e nivelit te dyte OTP si me poshte:

OTP (Nr kredie 057076)	11,109,140
OTP (Nr kredie 063137)	4,195,814
OTP (Nr kredie 074174)	135,509,466
OTP (Nr kredie 079860)	74,814,070

17. Kapitali i nenshkruar dhe rezervat

Kapitali i nenshkruar me 31.12.2022 eshte ne shumen **1,045,000,000 leke**.

Rezervat ligjore me 31.12.2022 jane ne shumen **85,311,263 leke**.

Rezervat e tjera me 31.12.2022 jane ne shumen **258,150,260 leke**.

Ne baze te Vendimit te Aksionereve te marre me 30.11.2022 "Shqyrtimi i raportit te zmadhimit te kapitalit", Asambleja ka miratuar alokimin e fitimit te shoqerise Gega Oil SHA ne shumen 20,253,975 leke (qe u perthith nga Gega Oil Group SHA) dhe fitimit neto pas bashkimit ne shumen 152,513,059 leke te vitit ushtrimor 2021, ne rritje kapitali ne vleren 152,000,000 leke dhe ne rritje te rezervave ligjore ne vleren 10,767,034 Leke.

Ne baze te vendimit te marre, Shoqeria ka paraqitur ne Pasqyren e Ndryshimeve ne Kapitalin Neto alokimin e fitimit neto nje pozicion financiar te deklaruar me 31 Dhjetor 2022 si "Kapital" dhe "Rezerva Ligjore" dhe "Fitimi i Pashperndare" per shumat respektive.

18. Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit.

Rakordimi i shifres se afarizmit per vitin ushtrimor 2022

Shifra e afarizmit sipas FDP-ve te dorezuara eshte ne shumen 44,358,606,676 leke.

Shifra e afarizmit sipas pasqyrave financiare eshte ne shumen 44,284,978,829 leke

Diferenca deklaruar me pak ne bilanc ne shumen

73,627,847 leke



Kjo vjen per arsye se:

Shuma prej 76,040,488 leke jane fatura parapagime per klientet dhe jo furnizim malli.

Shuma prej 2,413,490 leke parapagime te cilat kane qene ne llogarine e parapagimeve per blerje dhe jo ne llogarine e parapagimeve te marra per shitjet, ne vitin 2021.

Diferenca eshte e barabarte me 73,627,847 - (76,040,488 - 2,413,490).

Diferenca eshte 849 leke (73,627,847 - 73,626,998) shifer e pa perfillshme

Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit per periudhen e mbyllur me 31 dhjetor 2022 jane ne shumen **44,209,269,676 leke** dhe perbehen nga sa me poshte:

	Per periudhen e mbyllur me 31 dhjetor 2022
Te ardhura nga aktiviteti kryesor	44,209,269,676
Te ardhura te tjera (nga shitja e punimeve dhe sherbimeve)	75,709,153
Totali	44,284,978,829

Te ardhurat e Shoqerise nga aktiviteti kryesor i saj, konsistojne ne shitjen e karburanteve brenda vendit dhe per eksport.

Te ardhurat e tjera nga shitja e punimeve dhe sherbimeve konsistojne ne situacionet e punimeve qe jane bere per shoqerine Gega Center GKG SHPK per pikat e karburantit ne pronesi te saja.

19. Lende te pare dhe materiale te konsumueshme.

Keto shpenzime per vitin 2022 jane ne shumen **43,296,343,573 leke** dhe perbehen nga sa me poshte:

Ndrysh.gjend.mallra	(1,013,547,774)
Blerje /shpenzime mallra, sherbimesh	33,668,904,189
Tatim mbi qark. dhe akciza (pjese e kostos)	10,640,987,158

20. Te tjera shpenzime.

Keto shpenzime per vitin 2022 jane ne shumen **569,847,405 leke** dhe perbehen nga sa me poshte:

602	Blerje /shpenzime te materialeve te tjera	42,890,227
604	Bl.energji,avull,uje, karburant	220,935,455
609	Materiale te ndryshme per situacion	12,294,320
615	Mirembajtje dhe riparime	15,902,746
621	Personel nga jashte ndermarjes	5,104,244
626	Shpz.postare e telekom.	1,994,833
6271	Transporte per blerje	85,000
6272	Transporte per shitje	3,756,427



634	Taksa dhe tarifa vendore	1,038,964
638	Taksa kombetare e Tatime te tjera	764,283
657	Gjoha dhe demshperblime	116,345
658	Shpenzime te tjera	264,964,561
	Shuma	569,847,405

21. Shpenzime te personelit.

Keto shpenzime per vitin 2022 jane ne shumen **64,452,547 leke** dhe perbehen nga sa me poshte:

641	Pagat e personelit	55,363,625
644	Sig. shoq. dhe shendetesore (punedhenesi)	9,088,922

22. Shpenzime konsumi dhe amortizimi.

Shpenzimet e amortizimit te AAM-ve per vitin 2022 jane ne shumen **46,728,148 leke**.

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke perdorur metoden e vleres se mbetur te amortizimit mbi jeten e vleresuar te cdo pjese te aktivitetit afatgjate material duke filluar nga dita e pare e muajit qe pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira shoqeria jone nuk ka, por po te kishte ato do te amortizoheshin duke marre per baze periudhen me te shkurter midis periudhes se qirase dhe jetes se dobishme te aktivitetit.

Jetegjatesia e vleresuar per vitin aktual eshte si me poshte:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndertime	Vlere e mbetur	5%
Makineri e paisje	Vlere e mbetur	5%
Mjete transporti	Vlere e mbetur	20%
Paisje zyre	Vlere e mbetur	20%
Paisje kompjuterike	Vlere e mbetur	25%

Ne faqen nr 17 te relacionit eshte edhe tabela permbledhese e AAM-ve me vlefte fillesatre, amortizimin dhe me vlefte te mbetur

23. Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme

Shpenzimet e interesave dhe shpenzimeve te ngjashme per vitin 2022 jane ne shumen **64,243,426 leke** dhe perbehen nga si me poshte:

6671	Interesa kredie OTP Banke	13,298,770
6675	Interesa overdrafti OTP Banke	33,976,168
6676	Interesa overdrafti Raiffeisen Banke	16,968,488

24. Shpenzime te tjera financiare.

Shpenzime te tjera financiare per vitin 2022 jane ne shumen **68,862,837 leke** dhe perbehen nga si me poshte:

Fitim nga kembimet valutore ne shumen + 31,189,625 leke.
Sherbime bankare, komisione bankare - 3,472,854 leke.



Humbje nga kembimet valutor - 96,579,609 leke.

25. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin dhe fitimi pas tatimit.

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin dhe fitimi pas tatim fitimit per periudhen e mbyllur me 31 dhjetor 2022 perbehet nga sa me poshte:

Fitimi kontabel viti 2022	174,500,892
Shpenzime te pa njohura (llog 657)	116,345
Fitimi fiskal viti 2022	174,617,237
Tatim fitimi viti 2022 (15%)	26,192,586
Parapagim tatim fitimi viti 2022	27,810,001
Mbipagim tatim fitimi viti 2022	1,617,415
Fitimi kontabel 2022 pas tatim fitimit	148,308,306

26. Ngjarje te metejshme

Nuk ka ngjarje te tjera pas dates se raportimit qe kerkojne veprime rregulluese ose shenime shpejguese pervecse sa detajuar me lart.

27. Angazhime dhe Pasigurite

Nuk ka angazhime dhe pasiguri qe kerkojne paraqitje ose korrigjim ne pasqyrat financiare.

Drejtori Finances

Fatos MUÇAJ



Perfaqesuesi Ligjor

Olsi BEJTA

